

Në bazë të nenit 50 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 05/02) dhe nenit 3 të Vendimit për përcaktimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit", nr. 5/22), Kryetarja Qytetit të Shkupit më 04.05.2022 solli:

**RREGULLORE
PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT TË PAGESËS SË
KOMPENSIMIT TË DËMIT TË SHKAKTUAR NGA KAFSHIMI I
QENVE ENDACAKË**

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet procedura për përcaktimin dhe pagesën, si dhe mënyrën e zgjidhjes së kërkesave të qytetarëve për kompensim material dhe jo material (në tekstin e mëtejshëm: dëmi) të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë, në hapësirat publike në territorin e Qytetit të Shkupit.

Neni 2

(1) Si qen endacak në kuptimin e kësaj Rregulloreje konsiderohet çdo qen që nuk ka pronar apo mbajtës, i privuar nga kujdesi njerëzor, përkujdesja dhe mbikëqyrja, i gjetur në hapësirë publike në territorin e Qytetit të Shkupit.

(2) Nën termin hapësira publike nga paragrafi 1 i këtij neni nënkuptohen:

- hapësira të trafikut publik - rrugë, trotuare, kalime për këmbësorë, korsi për këmbësorë dhe biçikleta, sheshe, brigje, nënkalime, mbikalime, ura, parkingje, shkallë që lidhin hapësirat e trafikut publik, stacione të transportit publik urban, stacione taksi etj.
 - hapësira publike të gjelbra – parqe të qytetit, park-pyje, peizazhe karakteristike, lulishte, brez toke anës ose ndërmjet hapësirave publike të trafikut në të cilat është mbjellë gjelbërim, hapësira të gjelbra në hapësira rreth objekteve publike, gjelbërim mbrojtës në argjinatura dhe sipërfaqe të ngjashme;
 - zhardinierë, belvederë, pushimore, shkallë dhe korsi dhe pajisje të ngjashme urbane dhe objekte si pjesë përbërëse e hapësirave të gjelbra publike;
 - hapësira sportive rekreative, pishina publike dhe sipërfaqe ujore, terrene sportive për fëmijë etj, dhe
 - sipërfaqe të hapura rreth objekteve publike,
- të përcaktuara me Vendimin për rendin komunal në qytetin e Shkupit.

Procedura

Neni 3

(1) Procedura për përcaktimin e pagesës së kompensimit të dëmit fillon me depozitimin e Kërkesës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë në territorin e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesë) nga ana e personit të dëmtuar (në tekstin e mëtejshëm: Kërkuesi).

- (2) Të bashkëngjitur me Kërkesën, Kërkuesi duhet të depozitojë:
- Kartë identiteti ose pasaportë të vlefshme për kontroll, ndërsa kur i dëmtuari është minoren, depozitohen dokumente të prindërve ose kujdestarit;
 - Dokumentacion mjekësor nga institucion shëndetësor për trajtimin e lëndimit të shkaktuar nga kafshimi i qenit endacak;
 - Vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (stacioni policor ku është raportuar ngjarja) ;
 - Fotografi nga lëndimi;
 - Përshkrim i shkurtër i ngjarjes kur ka ndodhur sulmi;
 - Deklaratë nga dëshmitarë (nëse ka);
 - Kopje nga llogaria fiskale për shpenzimet e bëra në lidhje me ngjarjen;
 - Kopje nga llogaria e transaksionit e Kërkuesit

(3) Kërkesa dhe dokumentet nga paragrafi 2 i këtij neni depozitohen nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit pranë Komisionit për veprimin në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit.

(4) Kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit, në procedurë gjyqësore, konsiderohet si kërkesë e depozituar nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse paditësi dakordohet të fillojë procedura për përcaktimin e pagesës së kompensimit të dëmit, para Qytetit të Shkupit.

(5) Pëlqimin për fillimin e procedurës, nga paragrafi paraprak i këtij neni, paditësi e depoziton me shkrim.

(6) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni përfundon para skadimit të afatit kur vjetrohet kërkesa për kompensimin e dëmit të shkaktuar, e llogaritur nga dita e ndodhjes së lëndimit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë, të ndodhura në hapësira publike në territorin e Qytetit të Shkupit.

(7) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (6) i këtij neni, Komisioni nuk do të veprojë në lidhje me kërkesat e depozituara dhe të njëjtat do t'i refuzojë pa përjashtim.

Komisioni

Neni 4

(1) Për përcaktimin e vlerës së pagesës së kompensimit të shkaktuar të dëmit, Kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komision për veprim në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Mandati i Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni është 1 (një) vit.

(3) Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe zëvendësit e tyre si më poshtë:

- 1 (një) anëtar dhe 1 (një) zëvendës anëtar nga radhët e të punësuarve në Qytetin e Shkupit – Sektori për çështje juridike,
- 1 (një) anëtar dhe 1 (një) zëvendës anëtar nga NP "LAJKA" Shkup,

- 1 (një) anëtar dhe 1 (një) zëvendës anëtar nga radhët e mjekëve të licencuar traumatologë dhe
- 2 (dy) anëtarë dhe 2 (dy) zëvendës anëtarë nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e psikiatrisë.

(4) Anëtarët e Komisionit dhe zëvendësit e tyre nga paragrafi 3 alineja 3 dhe 4 i këtij neni, zgjidhen nëpërmjet thirrjes publike, të shpallur në të paktën dy gazeta ditore, nga të cilat një në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase dhe të njëjtët duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të posedojë dokument të vlefshëm për identifikim personal,
- Të posedojë licencë të vlefshme për punë të lëshuar nga Dhoma e Mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të ketë minimum 5 vjet eksperiencë pune si mjek specialist - traumatolog përkatësisht në fushën e psikiatrisë.

(5) Eksperienca në trajtimin e plagëve dhe lëndimeve nga kafshimi i qenve endacakë (traumatolog) ose eksperienca e punës (diagnostikim) me persona të cilët kanë përjetuar frikë dhe dhimbje shpirtërore nga kafshimi i qenve (nga fusha e psikiatrisë), do të konsiderohet si përparësi.

Neni 5

(1) Anëtarëve të Komisionit dhe zëvendësve të tyre, nga neni 4 paragrafi 3 alineja 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje u paguhet kompensim mujor për pjesëmarrje në punën e Komisionit, në këtë mënyrë:

- Anëtarëve nga radhët e mjekëve të licencuar traumatologë dhe nga radhët e mjekëve të licencuar nga fusha e psikiatrisë, kompensim në vlerën 25.000,00 denarë, në vlerë neto;
- Zëvendës anëtarëve të Komisionit nga radhët e mjekëve të licencuar traumatologë dhe nga radhët e mjekësve të licencuar nga fusha e psikiatrisë u paguhet kompensim në vlerën 25.000,00 denarë, të cilat paguhen në muajt kur zëvendësojnë anëtarët e Komisionit, për shkak të mospjesëmarrjes në seancën e Komisionit.

(2) Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Komisionit paguhet për pjesëmarrje në seancën e Komisionit në muajin në vijim.

(3) Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Komisionit nuk paguhet gjatë mungesës përkatësisht mospjesëmarrjes në asnjë seancë të Komisionit të muajit në vijim.

(4) Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seanca nuk paguhet, nëse Komisioni gjatë muajit në vijim nuk ka mbajtur seancë.

Neni 6

Komisioni:

- shqyrton kërkesat për kompensimin e dëmit,

- jep propozime për vlerën e kompensimit të dëmit.

Mënyra e punës së Komisionit

Neni 7

(1) Komisioni punon në seanca.

(2) Nëse nga dokumentacioni i depozituar, Komisioni konstaton se nuk mund të vërtetohet me siguri gjendja faktike për pasojën që ka ndodhur, mund të kërkohet edhe dokumentacion plotësues të cilin Kërkuesi është i obliguar ta depozitojë.

(3) Për përcaktimin e gjendjes faktike nga paragrafi paraprak Komisioni mund të kërkojë ekspertizë, që do të përgatitet nga ekspertë të autorizuar dhe në barrë të Qytetit të Shkupit.

(4) Nëse Kërkuesi nuk e kompletton dokumentacionin nga paragrafi 2 i këtij neni, Kërkesa do të refuzohet si e pabazuar.

Seancat e Komisionit

Neni 8

(1) Seancat e Komisionit i thërret dhe me ta drejton Kryetari ose zëvendës kryetari i Komisionit, i cili kujdeset për organizimin dhe punën e Komisionit.

(2) Seancat e Komisionit mund të mbahen vetëm nëse në ta marrin pjesë të paktën 3 anëtarë ose zëvendësit e tyre nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, nga të cilët 2 anëtarë ose zëvendësit e tyre janë mjekë specialistë, si më poshtë: 1 (një) traumatolog dhe 1 (një) nga fusha e psikiatrisë.

(3) Në seancat e Komisionit detyrimisht merr pjesë edhe nga një përfaqësues nga Sektori për Çështje Komunale edhe Sektori për Çështje Juridike për shkak të dhënies së mbështetjes administrativo-teknike.

(4) Me ftesë të kryetarit të Komisionit, në seancën e Komisionit mund të marrë pjesë edhe Kërkuesi dhe dëshmitarët e ngjarjes (nëse ka).

(5) Pas dëshmive të Kërkuesit dhe dëshmitarëve, atyre mund t'ju drejtojë pyetje çdo anëtar i Komisionit.

Neni 9

(1) Nëse gjatë punës së Komisionit konstatohet se për shkak të konstatimit më konkret të ngjarjes dhe dëmit të ndodhur, është e nevojshme të dëgjohen Kërkuesi dhe dëshmitarët e ngjarjes, nëse janë listuar, kryetari i Komisionit do të thërrasë seancë të re në të cilën do të ftojë Kërkuesin dhe dëshmitarët.

(2) Nëse Komisioni konstaton se në përputhje me dokumentacionin e depozituar dhe dëshmitë e dhëna nuk i është shkaktuar dëm Kërkuesit, ose nga dëshmitë e Kërkuesit përkatësisht dëshmitarëve të ngjarjes konstatohet mosbesueshmëria e tyre, me konkluzion Kërkesën do ta refuzojë si të pabazë.

Ndalimi i procedurës

Neni 10

Nëse Komisioni konstaton se dëmi nuk është shkaktuar nga kafshimi i qenit endacak, përkatësisht gjendet pronari i qenit, Komisioni me konkluzion ndalon procedurën për kërkesën e kompensimit dhe Kërkuesi do ta drejtojë të drejtën e tij për realizim nëpërmjet padisë private kundër pronarit të qenit, pranë gjyqit kompetent.

Përcaktimi i vlerës së kompensimit

Neni 11

Nëse Komisioni mbi bazën e dëshmimeve të depozituara dhe vërtetimit të gjendjes faktike konstaton se Kërkesa është e bazuar, në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore, jep propozim për kompensimin e Kërkuesit dhe përcakton vlerën e kompensimit të dëmit, gjë për të cilën personit të dëmtuar do t'i ofrohet marrëveshje.

Kritere për përcaktimin e vlerës së kompensimit

Neni 12

(1) Gjatë shqyrtimit të çdo kërkesë në veçanti, Komisioni merr parasysh kriteret e mëposhtme për përcaktimin e vlerës së kompensimit:

	Kritere për përcaktimin e vlerës së kompensimit	Pikë maksimale
	Dëmi material dhe jo material i shkaktuar mbi të dëmtuarin vlerësohet mbi bazën e	
1.	Lloji kafshimit: - kafshim i fortë - kafshimi mesëm - gërvishtje	15 10 5
2.	Numri i kafshimeve: - më shumë se një - një - për gërvishtje	15 10 5
3.	Shkalla e frikës së përjetuar: - shkallë e lartë - shkallë e mesme - shkallë e ulët - nuk ka	15 10 5 0
4.	Mosha e të lënduarit	
	-Fëmijë (person deri në moshën 18 vjeç)	15
	-Person nga mosha 18 deri në 65 vjet	10
	-Person mbi 65 vjeç	5
5.	Pasojat që kanë ndodhur si rezultat i kafshimit:	
a.	Gjymtim: - i lartë - i mesëm	20 15

	- i ulët - nuk ka	10 0
b.	Çrregullimi i gjendjes psikike nga frika e përjetuar/trauma: -intensiv -mesatar - i lehtë - nuk ka	20 15 10 0
	PIKË GJITHSEJ	

Vlera e kompensimit

Neni 13

Në bazë të kriterëve nga Neni 12 i kësaj Rregulloreje, vlera e kompensimit për dëmin e pësuar mund të përcaktohet në vlerën:

Deri në 40 pikë	nga 30.000,00	denarë deri në	50.000,00 denarë
Nga 41 - 60 pikë	nga 50.000,00	denarë deri në	70.000,00 denarë
Nga 61 - 80 pikë	nga 70.000,00	denarë deri në	90.000,00 denarë
Nga 81 - 100 pikë	nga 90.000,00	denarë deri në	100.000,00 denarë.

Neni 14

Komisioni depoziton pranë Kryetares së Qytetit të Shkupit propozimin për kompensimin e Kërkuesit në të cilin është përcaktuar vlera e kompensimit të dëmit së bashku me procesverbalin për procedurën e zbatuar.

Neni 15

Për punën e Komisionit mbahet procesverbal.

Marrëveshja

Neni 16

(1) Mbi bazën e propozimit nga Neni 14 i kësaj Rregulloreje, Kërkuesit i dorëzohet Marrëveshja me të cilën propozohet vlera e kompensimit të dëmit.

(2) Kërkuesi është i detyruar më së voni në një afat prej 7 ditësh nga pranimi i Marrëveshjes të njëjtën ta pranojë ose refuzojë.

(3) Nëse pas skadimit të afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, Kërkuesi nuk deklarohet nëse e pranon apo e refuzon Marrëveshjen, do të konsiderohet se heq dorë nga e drejta për kompensimin e dëmit të ndodhur si pasojë e kafshimit nga qen endacak, në procedurën para Qytetit të Shkupit.

Dispozita përfundimtare

Neni 17

Kërkesat për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kafshimi i qenve endacakë në territorin e Qytetit të Shkupit plotësohen në një formular të veçantë i cili mund të merret në Arkivin e Qytetit të Shkupit ose në ueb-faqen zyrtare të Qytetit www.skopje.gov.mk.

Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT
Danela Arsovska
